

VERSIONI EKZEKUTUES

(Numri i operimit 52167)

MARRËVESHJA E KREDISË
(VISP: Kredia e likuiditetit të urgjencës së infrastrukturës vitale)

ndërmjet

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

dhe

BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Datë _____ 2020

TABELA E PËRMBAJTJES

NENI I - KUSHTET DHE SHPREHJET STANDARDE; PËRKUFIZIMET.....	5
Paragrafi 1.01. Përfshirja e kushteve dhe shprehjeve standarde	5
Paragrafi 1.02. Përkufizimet.....	6
Paragrafi 1.03. Interpretimi	112
NENI II - KUSHTET KRYESORE TË KREDISË	113
Paragrafi 2.01. Shuma dhe valuta	113
Paragrafi 2.02. Kushtet tjera financiare të kredisë	123
Paragrafi 2.03. Tërheqjet	134
NENI III - ZBATIMI I PROJEKTIT	134
Paragrafi 3.01. Marrëveshjet tjera afirmative të projektit	134
Paragrafi 3.02. Njësia për Zbatimin e Projektit	146
Paragrafi 3.03. Prokurimi	156
Paragrafi 3.04. Marrëveshjet e pajtueshmërisë mjedisore dhe sociale	156
Paragrafi 3.05 Konsulentët.....	1615
Paragrafi 3.06. Shpeshhtësia e raportimit dhe kërkesat e dorëzimit	167
NENI IV - MARRËVESHJET FINANCIARE.....	20
Paragrafi 4.01. Të dhënat financiare dhe raportet	20
NENI V - PEZULLIMI; SHPEJTIMI;	20
Paragrafi 5.01. Pezullimi	20
Paragrafi 5.02. Shpejtimi i maturitetit	21
NENI VI - EFIKASITETI	21
Paragrafi 6.01. Kushtet paraprijëse të efikasitetit	21
Paragrafi 6.02. Kushtet paraprijëse të të gjithë tërheqjes së këstit 1	21
Paragrafi 6.03.Kushtet paraprijëse të disponueshmërisë së tërheqjeve të këstit 2.....	22
Paragrafi 6.04. Mendimi ligjor	23
Paragrafi 6.05. Ndërprerja për dështim të të bërit efektiv	23
NENI VII - TË NDRYSHME	213
Paragrafi 7.01. Njoftimet	213
PLANI 1 - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT.....	1
PLANI 2 - KATEGORITË DHE TËRHEQJET	1
PLANI 3 - FORMA E MARRËVESHJES SË NËNHUAZIMIT.....	1

MARRËVESHJE PËR KREDI

MARRËVESHJE datë _____ 2020 ndërmjet **REPUBLIKËS SË KOSOVËS** përfaqësuar nga **Ministria e Financave** ("Huamarrësi") dhe **BANKËS EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM** ("Banka").

HYRJE

NDËRSA, Banka është themeluar për të ofruar financim për projekte specifike për të nxitur kalimin drejt ekonomive të hapura të orientuara nga tregu, dhe për të promovuar nismën private dhe të ndërmarrësisë në disa vende të përkushtuara për të zbatuar parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe ekonomisë së tregut;

NDËRSA, Huamarrësi ka për qëllim që të zbatojë projektin siç përshkruhet në planin 1 i cili është krijuar për të ndihmuar Huamarrësin në ofrimin e financimit të likuiditetit emergjent për ofruesit e infrastrukturës vitale të prekur nga kriza pandemike COVID-19;

NDËRSA, Huamarrësi ka kërkuar ndihmë nga Banka për financimin e projektit;

NDËRSA, Banka është pajtuar që të vë në dispozicion *(i)* fonde të bashkëpunimit teknik për një shumë deri në 40,000 EUR (dyzet mijë euro) mbi bazën e një granti *për fazën e projektit (a)* në lidhje me një program mjedisor dhe ndërtimi të kapaciteteve mjedisore dhe sociale për Nën-Huamarrësit të pranueshëm sipas praktikës së mirë ndërkombëtare; *(b)* të mbështesë NZP në zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi monitorimi që plotëson standardet e Bankës për kohëzgjatjen e Projektit; dhe *(ii)* është në proces të rregullimit të fondeve të bashkëpunimit teknik *(a)* për një shumë që do të caktohet për të ndihmuar Huamarrësin për zhvillimin e një politike shtetëtare të pronësisë për ndërmarrjet në pronësi publike, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare dhe *b)* për një shumë prej 75.000 € (shtatëdhjetë e pesë mijë euro) për angazhimin e një auditori të pavarur për të vlefësuar përpushshmërinë me kriteret e pranueshmërisë; duke iu nënshtruar kushteve dhe shprehjeve që do të përcaktohen në një marrëveshje *(t)*, që do të lidhet *(n)* midis Bankës dhe Huamarrësit;

NDËRSA, Banka është pajtuar sipas, siç u tha më lart që të ofrojë një kredi për Huamarrësin në shumë prej 30,000,000 Euro (tridhjetë milionë euro), duke iu nënshtruar kushteve dhe shprehjeve të përcaktuara ose të theksuara në këtë Marrëveshje.

TANI, PRANDAJ, përmes kësaj palët pajtohen si më poshtë:

NENI I – KUSHTET DHE SHPREHJET STANDARDE; PËRKUFIZIMET

Paragrafi 1.01. Përfshirja e kushteve dhe shprehjeve standarde

Të gjitha dispozitat e kushteve dhe shprehjeve standarde të Bankës, të datës 1 tetor 2018, me këtë përfshihen dhe bëhen të zbatueshme për këtë Marrëveshje me të njëjtën forcë dhe efekt, sikur të ishin të përcaktuara plotësisht këtu, sidoqoftë duke iu nënshtruar ndryshimeve të mëposhtme (të tilla dispozita të ndryshuara në tekstin e mëtejshëm quhen "Kushtet dhe shprehjet standarde"):

(a) Paragrafi 3.01 (a) i kushteve dhe shprehjeve standarde, për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshohet që të lexohet si më poshtë:

"(a) Data e fundit e disponueshmërisë

E drejta e Huamarrësit që të tërheqë nga Shuma në Dispozicion do të:

(1) të bëhet efektive (i) sa i përket kështit 1, në datën efektive; dhe (ii) sa i përket kështit 2, subjekt i paragrafit 6.03 të Marrëveshjes së Kredisë, në datën në të cilën Banka ka njoftuar Huamarrësin se kështi 2 është bërë efektiv sipas paragrafit 2.01 (c) të Marrëveshjes së Kredisë; dhe

(2) të ndërpritet në datën e fundit të disponueshme ose një datë të tillë të mëvonshme, siç Banka mund të vendosë në diskrecionin e saj pas marrjes së një kërkesë paraprake me shkrim nga Huamarrësi. Banka njofton me shpejtësi Huamarrësin për çdo datë të tillë të mëvonshme."

(b) Paragrafi 3.05(a) i kushteve dhe shprehjeve standarde, për qëllim të kësaj Marrëveshjeje, do të ndryshohet që të lexohet si më poshtë:

"(a) Huamarrësi do t'i paguajë Bankës një tarifë të zotimit në masën e specifikuar në Marrëveshjen e Kredisë e pagueshme në shumën në dispozicion plus çdo shumë të Kredisë që i nënshtrohet një zotimi të rimbursimit dhe nuk është tërhequr ende, me kusht që tarifa e zotimit e pagueshme në shumën e kredisë që i nënshtrohet një zotimi të pakushtëzuar të rimbursimit do të jetë 0.5% në vit më e madhe se sa norma e tarifës së zotimit e specifikuar në Marrëveshjen e Kredisë. Tarifa e zotimit do të rrjedhë:

(1) për kështin 1, nga data që bie gjashtëdhjetë (60) ditë pas datës së Marrëveshjes së Kredisë; dhe

(2) për kështin 2, nga data që bie **pesëmbëdhjetë (15)** ditë pas datës së disponueshmërisë së kështit 2; dhe

(3) në rastin e tarifës së zotimit që paguhet mbi shumën e Kredisë që i nënshtrohet një zotimi të pakushtëzuar të rimbursimit, nga data e lëshimit të një zotimi të tillë të pakushtëzuar të rimbursimit;

me kusht që tarifa e zotimit do të rrjedhë dhe të llogaritet në të njëjtën bazë si kamatë sipas paragrafit 3.04 (b) (ii). Tarifa e zotimit do të jetë e pagueshme në secilën datë të pagesës së kamatës (edhe pse asnjë kamatë nuk mund të jetë e

pagueshme në datë të tillë) duke filluar nga data e parë e pagesës së kamatës pas datës efektive (datës së hyrjes në fuqi).”

(c) Një paragraf i ri (e) do të paraqitet në paragrafin 3.01 të kushteve dhe shprehjeve standarde që të lexohet si më poshtë:

”(e) Të gjitha shprehjet me shkronja të mëdha të përdorura në këtë paragrafin 3.01 dhe të cilat nuk përcaktohen ndryshe këtu, do të kenë kuptimin e përshkruar në shprehje të tilla në Marrëveshjen e Kredisë.”

d) Një paragraf i ri (e) do të paraqitet në paragrafin 3.05 të kushteve dhe shprehjeve standarde që të lexohet si më poshtë:

”(e) Të gjitha shprehjet me shkronja të mëdha të përdorura në këtë paragrafin 3.05 dhe të cilat nuk përcaktohen ndryshe këtu, do të kenë kuptimin e përshkruar në shprehje të tilla në Marrëveshjen e Kredisë.”

Paragrafi 1.02. Përkufizimet

Kudo që përdoret në këtë marrëveshje (përfshirë hyrjen dhe planet), përveç nëse deklarohet ndryshe ose konteksti kërkon ndryshe, shprehjet e përcaktuara në hyrje kanë kuptimet përkatëse të dhëna atyre në to, shprehjet e përcaktuara në kushtet dhe shprehjet standarde kanë kuptimet përkatëse dhënë atyre në to, dhe shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet siç vijon:

"Autorizimi"	nënkupton çdo pëlqim, regjistrim, paraqitje, marrëveshje, noterizim, çertifikatë, licencë, aprovim, leje, autorizim ose përjashtim nga, ose me ndonjë Autoritet Qeveritar, qoftë i dhënë ose i mbajtur me veprim të shprehur ose konsiderohet i dhënë ose mbajtur nga dështimi për të vepruar brenda ndonjë periudhe kohore të specifikuar dhe të gjitha pëlqimet ose miratimet e korporatave, kreditorëve dhe aksionarëve.
”Kontrollet kryesore Të integritetit”	nënkupton kontrollet e integritetit për të siguruar që palët e treta përkatëse nuk janë përjashtuar nga Banka në bazë të Politikës së Zbatimit dhe Procedurave ose në Listën e Konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe ekzaminimet e Kontrollit Botëror (përfshirë për përcaktimin e ”personit të ekspozuar politik”, dënimet penale dhe çështjet e ndërlidhura) për secilin Kontraktues Jo-Thelbësor
"Përfaqësuesi i autorizuar i huamarrësit"	nënkupton Ministria e Financave të huamarrësit.
"Kërkesat e caktuara të performancës"	nënkupton kërkesat e performancës 1 deri në 8 dhe 10 (apo, siç mund ta kërkojë konteksti, ndonjë prej kërkesave të tilla të performancës) të kërkesave të performancës datë

prill 2019 si dhe në lidhje me politikën sociale dhe mjedisore të bankës datë prill 2019.

"Projektligji mbi ndërmarrjet në pronësi publike"

nënkupton projektligjin për ndërmarrjen në pronësi publike të datës 29 qershor 2018, i disponueshëm publikisht në faqen e internetit të Zyrës për Qeverisje të Mirë - Zyra e Kryeministrit në: <https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=40415>].

"Politika sociale dhe mjedisore e BERZH-it"

nënkupton politikën sociale dhe mjedisore të BERZH-it datë prill 2019, siç është ndryshuar kohë pas kohe.

"Kriteret e pranueshmërisë"

nënkupton kriteret e mëposhtme:

- a. Kredia duhet të huazohet në tërësinë e saj për nën-huamarrësit e pranueshëm, dhe nuk mund të mbahet për qëllime buxhetore brenda huamarrësit;
- b. Të gjithë nën-huamarrësit e pranueshëm duhet të jenë në gjendje të demonstrojnë një humbje të të ardhurave për shkak të pandemisë COVID-19, dhe për shkak të masave të vëna nga Qeveria e Republikës së Kosovës për t'u përgjigjur krizës, dhe të vërtetohet si brengë në vazhdimësi përpara krizës së COVID-19;
- c. Dëshmi se, në mungesë të mbështetjes së likuiditetit, do të ekzistonte një rrezik i konsiderueshëm i rënies në ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës nga nën-huamarrësi i pranueshëm;
- d. Çdo nën-kredi për nën-huamarrës të pranueshëm do të mbulohet në një shumë prej 5,000,000 EUR (pesë milion euro);
- e. Të ardhurat e kredisë duhet të përdoren nga nën-huamarrësit e pranueshëm për të përmbushur detyrimet afatshkurtra të pagueshme brenda 12 muajve nga data relevante a Marrëveshjes për Nën-Kredi, ose nëse paguhet para nënshkrimit të marrëveshjes së kredisë subsidiare, brenda 12 muajve që nga data kur ato janë paguar që do të jetë jo më parë se 1 maj 2020, për të mbuluar, *mes tjerash*, pagesa për furnizuesit, të punësuarit, sa i përket vetëm punonjësve të nën-huamarrësve të pranueshëm të cilët janë ose ndërmarrje në pronësi të shtetit që ofrojnë shërbime të rëndësishme të infrastrukturës ose ndërmarrje pronë komunale që ofrojnë shërbime të rëndësishme të infrastrukturës, ose pagesa për ti vazhduar operacionet kryesore dhe mirëmbajtjen tanimë sipas kontratave të siguruara vendore, më

përfashtim të pagesës së ndonjë tatimi apo pagese të shpenzimeve kapitale;

- f. Banka do të vlerësojë profilin e integritetit të secilit nën-huamarrës të pranueshëm para çdo tërheqjeje, në përputhje me standardet e integritetit të brendshëm të Bankës, dhe do të ketë vetëm diskrecionin Bankës për të mos zgjidhur kandidatin relevant.
- g. Çdo nën-huamarrës i pranueshëm do të pajtohet me politikën e zbatimit dhe procedurat sipas planit 1 të marrëveshjes për nën-kredinë.
- h. Në rastin kur të ardhurat e një tërheqjeje do të përdoren nga një nën-huamarrës i pranueshëm, që është një komunë, kompani në pronësi të komunës, ose një ndërmarrje shtetërore jo e korporatizuar (siç vlerësohet nga banka në diskrecionin e vet) të bëjë një pagesë të konsiderueshme, banka do të vlerësojë dhe miratojë secilin kontraktues të tillë rëndësishëm para çdo tërheqjeje në pajtim me standardet e integritetit të brendshëm të Bankës dhe një kontraktues i tillë i rëndësishëm do të hyjë në formë të ndërmarrjes së integritetit, e parashikuar sipas marrëveshjes subsidiare të kredisë me huamarrësit e pranueshëm, me të cilin një kontraktues i tillë i rëndësishëm pajtohet, si kusht për të marrë fondet e kredisë, **mes tjerash**, për zbatimin e politikës së zbatimit dhe procedurave, si dhe qasjes së bankës, të drejtat e auditimit dhe kontrollit, dhe
- i. Në rastin kur të ardhurat e një tërheqjeje do të përdoren nga një nën-huamarrës i pranueshëm, që është një komunë, kompani në pronësi të komunës, një ndërmarrje shtetërore jo e korporatizuar (siç vlerësohet nga banka në diskrecionin e vet) për të bërë një pagesë jo-të rëndësishme, banka do të kryejë kontrollet themelore të integritetit për secilin kontraktor të jo-rëndësishëm, dhe do të vërtetojë pranueshmërinë e një kontraktori të tillë jo-të rëndësishëm si kusht për të pranuar fondet e kredisë.

"Nën-huamarrës
i pranueshëm"

nënkupton një *ndërmarrje* në pronësi të shtetit që ofron shërbime të rëndësishme të infrastrukturës, një kompani në pronësi të komunës që ofron shërbime të rëndësishme të infrastrukturës, ose një komunë që ofron shërbime të rëndësishme të infrastrukturës.

"Politika e zbatimit dhe
procedurat"

nënkupton politika e zbatimit dhe procedurat e bankës datë 4 tetor 2017, sipas ndryshimit të kohëpaskohshëm, dhe çdo politike apo procedure të miratuar nga BERZH-i si

pasuese e ose zëvendësuese e politikave të tilla ose procedurave.

- "Dokumenti mjedisor dhe social për shpalosje të klientit" nënkupton informacionin e shkruar të paraqitur nga ose në emër të huamarrësit për bankën që përmban informacione, ndër të tjera, lidhur me çështjet mjedisore dhe sociale dhe çdo ndryshim ose plotësim i informacionit të tillë i cili është pranuar nga banka.
- "Ligji mjedisor dhe social" nënkupton çdo ligj të zbatueshëm në çdo juridiksion përkatës, në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, punëtorët, komunitetet apo njerëzit e prekur nga projekti.
- "Çështja mjedisore dhe sociale" nënkupton çdo çështje e cila i nënshtrohet çdo ligji mjedisor dhe social apo çdo kërkesë të caktuar të performancës.
- "Viti fiskal" nënkupton viti fiskal i huamarrësit që fillon më 1 janar të secilit vit.
- "Parimet në përgjithësi të pranueshme të kontabilitetit" nënkupton parimet e kontabilitetit në përgjithësi të pranueshme në Republikën e Kosovës dhe vazhdimisht të zbatueshme.
- "Autoriteti qeveritar" nënkupton qeverinë e huamarrësit, apo çdo nënndarje politike të saj, qoftë shtetërore, rajonale apo, lokale, dhe çdo agjenci autoritet, degë, departament, organ rregullator, gjykatë, bankë qendrore apo subjekt tjetër i cili ushtron detyra ekzekutive, legjislative, gjyqësore, tatimore, rregullatore ose administrative ose funksione që kanë të bëjnë me qeverinë apo çdo nënndarjeje të saj (përfshirë çdo organ mbi-nacional), dhe të gjithë zyrtarët, agjentët dhe përfaqësuesit e secilës prej të përmendurve si më lart.
- "Konsulent i pavarur Mjedisor dhe social" nënkupton një kompani të konsulentëve e cila mund të zgjidhet kohë pas kohe nga banka.
- "Kontraktor jo-i rëndësishëm" nënkupton një pale të tretë (p.sh. një kontraktor ose një nën-kontraktor), që mund të pranojë një pagesë jo-të rëndësishme nga fondet e kredisë.
- "Pagesë jo-e konsiderueshme" nënkupton ose (i) pagesa për një kontraktor të vetëm në shumën totale prej 75,000 EUR (shtatëdhjetë e pesë mijë euro) ose më poshtë në vit me kusht që vlera vjetore e kontratës të jetë 75,000 EUR (shtatëdhjetë e pesë mijë euro), apo më poshtë, ose (ii) pagesa për një kontraktor të vetëm në shumën totale prej 75,000 EUR (shtatëdhjetë e

pesë mijë euro) apo më poshtë, në vit në rast se vlera e kontratës nuk është e përcaktueshme, për përjashtim të çdo pagese të lejuar të palëve të treta.

"Pagesa e lejuar e palëve të treta"	do të thotë pagesa (i) palëve të treta për blerjen e (a) shërbimeve komunale, përfshirë shërbimin e telekomunikimeve, kur një ofrues i tillë i shërbimit është zgjedhja e vetme e furnizuesit; (b) harxhimet e zyrës dhe pajisjet dhe shërbimet e rastësishme të zyrës; (c) mbulimi i sigurimit; dhe (ii) punonjësve për pagat dhe shpenzimet e personelit të shoqëruar
"Palë e tretë E lejuar si kontraktor"	nënkupton një palë ndaj së cilës është bërë një pagesë e lejuar për palë të treta
"NZZP"	nënkupton njësinë e zbatimit të projektit referuar në paragrafin 3.02.
"Nën-kredi"	nënkupton një kredi që i plotëson kriteret e pranueshmërisë që janë bërë apo propozuar të bëhen nga huamarrësi për një nën-huamarrës të pranueshëm nga të ardhurat e një tërheqjeje.
"Marrëveshja subsidiare e kredisë"	<p>nënkupton marrëveshjen/et e kredisë që duhet të nënshkruhet ndërmjet huamarrësit dhe nën-huamarrësit të pranueshëm në pajtim me paragrafin 3.01 (a), pasi marrëveshja/et e tillë/a e/të kredisë mund të ndryshohet/n kohë pas kohe, që do të jetë në formë dhe substancë të kënaqshme për bankën dhe kryesisht sipas formularit të planit [4] (<i>Formulari i marrëveshjes subsidiare të kredisë</i>), dhe e cila, mes tjerash do të përfshijë:</p> <ol style="list-style-type: none">a. Një kohëzgjatje minimale prej një viti;b. zbatimin e politikës së zbatimit dhe procedurave për të siguruar që standardet e integritetit të bankës janë përmbushur dhe respektuar, përfshirë në veçanti:c. pajtueshmërinë e profilit të integritetit të secilit nën-huamarrës të pranueshëm para çfarëdo tërheqjeje me standardet e integritetit të brendshëm të bankës me diskrecionin e vet bankës për të mos zgjidhur një kandidat relevant;d. Marrëveshje nga secili nën-huamarrës i pranueshëm për zbatimin e politikës së zbatimit dhe procedurave sipas planit [1] të marrëveshjes së nën-kredisë;e. në rastin kur të ardhurat e një tërheqjeje do të përdoren nga një nën-huamarrës i pranueshëm, që është një komunë, një ndërmarrje në pronësi të komunës, ose

një ndërmarrje shtetërore jo e korporatizuar (siç vlerësohet nga Banka në diskrecionin e saj të vetëm), për të bërë një pagesë të konsiderueshme, nën-huamarrësi i pranueshëm do të sigurojë se banka ka vlerësuar dhe miratuar secilin kontraktues të tillë të rëndësishëm para çdo tërheqje, në përputhje me standardet e integritetit të brendshëm të Bankës, dhe se kontraktori i tillë i rëndësishëm ka hyrë në Formë të Integritetit të Ndërmarrjes, e parashikuar sipas planit [2] të marrëveshjes së kredisë subsidiare me nën-huamarrësit e pranueshëm, me anë të të cilave një kontraktor i tillë i rëndësishëm pajtohet, si kusht për marrjen e fondeve të kredisë, *mes tjerash*, për zbatimin e politikës së zbatimit dhe procedurave, si dhe ndaj të bankës për qasje, auditim dhe inspektim.

- f. në rastin kur të ardhurat e një tërheqje do të përdoren nga një nën-huamarrës i pranueshëm, që është një komunë, një ndërmarrje në pronësi të komunës ose një ndërmarrje shtetërore jo e korporatizuar (siç vlerësohet nga banka në diskrecionin e vet) të bëjë një pagesë jo të konsiderueshme, nën-huamarrësi i pranueshëm do të sigurojë se banka ka kryer kontrollin themelore të integritetit për secilin kontraktor jo-të rëndësishëm, dhe se ka konfirmuar pranueshmërinë e një kontraktori të tillë jo-të rëndësishëm si kusht për marrjen e fondeve të kredisë;
- g. Ofrimin nga huamarrësi për bankën të një deklaratë të nënshkruar nga Ministria e Financave e Republikës së Kosovës se kriteret e pranueshmërisë janë përmbushur nga nën-huamarrësit e pranueshëm në kohën e disburimit të këtyre fondeve sipas kredisë, sipas planit 1 të marrëveshjes së kredisë subsidiare
- h. një kërkesë për nën-huamarrësit e pranueshëm për të drejtuar bizneset e tyre në përputhje me rregulloren kombëtare në lidhje me mjedisin, shëndetin dhe sigurinë dhe kushtet e punës;
- i. një kërkesë për nën-huamarrësit e pranueshëm për të përdorur fondet e kredisë në përputhje me kriteret e pranueshmërisë, dhe
- j. një kërkesë për të mos përdorur të ardhurat e kredisë për të financuar (i) çdo subjekt ose individ të përjashtuar nga Banka në bazë të politikës së zbatimit dhe procedurave ose në Listën e Konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nën Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara ose (ii) kontrata me një subjekt që është në pronësi ose kontrollon nga një "person i ekspozuar politikisht" siç përcaktohet nga Task Force e Veprimit Financiar,

ose që është një "palë e ndërlidhur" siç përcaktohet nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 24, ose kur ekziston një fakt ose i dukshëm konflikti i interesit midis palëve kontraktuese; për shmangien e dyshimit, asnjë nën-huamarrës i pranueshëm, kontraktor i rëndësishëm, kontraktor jo-i rëndësishëm, ose kontraktor i lejuar i palës së tretë, nuk do të bjerë, për qëllime të nën-kredisë në fushëveprimin e pikave (i) ose (ii).

"Kontraktor i rëndësishëm" nënkupton një palë të tretë (p.sh. kontraktor ose nën-kontraktor i cili (i) aktualisht ka një kontratë ose një seri kontratash me një nën-huamarrës të pranueshëm, që, në total, kanë një vlerë totale të kontratës më të tepërt 75,000 EUR (shtatëdhjetë e pesë mijë euro) ose (ii) faturat aktuale dhe të pritura të të cilave dhe/ose kërkesat për pagesa për një nën-huamarrës të pranueshëm në periudhën aktuale të llogaritjes 12 (dymbëdhjetë) muaj, në total, e tejkalojnë ose pritet të kalojnë 75,000 EUR (shtatëdhjetë e pesë mijë euro)

"Pagesë e konsiderueshme" nënkupton pagesën ose pagesat që përdorin fondet e kredisë për një kontraktor të rëndësishëm, me përjashtim të ndonjë pagese të lejuar për palë të treta.

"Kësti 1" ka kuptimin e dhënë në paragrafin 2.01(b)(1).

"Kësti 2" ka kuptimin e dhënë në paragrafin 2.01(b)(2).

"Data e disponueshmërisë Së Këstit 2" nënkupton datën prej nga e cila Kësti 2 bëhet i zotuar dhe i disponueshëm për tërheqje siç njoftohet nga banka për huamarrësin. Një vendim i tillë do të bëhet në diskrecion të bankës në pajtim me paragrafin 2.01(c).

Paragrafi 1.03. Interpretimi

Në këtë marrëveshje, një referencë në një nen, paragraf ose plan, përveç nëse deklarohet ndryshe në këtë marrëveshje, do të interpretohet si referencë e atij neni, paragrafi ose plani të specifikuar ndaj kësaj marrëveshjeje.

NENI II – SHPREHJET KRYESORE TË KREDISË

Paragrafi 2.01. Shuma dhe valuta

(a) Banka pajtohet që ti japë huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara apo referuara në këtë marrëveshje, shumën prej 30,000,000 Euro (tridhjetë milionë euro).

(b) Kredia do të përbëhet nga dy këste, siç vijon:

(1) Kësti 1 në shumë prej 14,000,000 Euro (katërbëdhjetë milionë euro), për të financuar likuiditetin e menjëhershëm emergjent të huamarrësit si mbështetje për ofruesit e infrastrukturës së rëndësishme ("Kësti 1"); dhe

(2) Kësti 2 në shumë prej 16,000,000 Euro (gjashtëmbëdhjetë milionë euro), për të financuar, siç është kërkuar, për të financuar likuiditetin e huamarrësit si mbështetje për ofruesit e infrastrukturës së rëndësishme derisa të rikthehen të hyrat dhe arkëtimet e tyre ("Kësti 2").

(c) Pavarësisht nga çdo gjë e kundërt, e shprehur apo e nënkuptuar, në këtë marrëveshje, kësti 2 është i pazotuar dhe do të bëhet i zotuar vetëm pasi Banka të ketë përcaktuar në diskrecionin e saj absolut se është e përgatitur për të vënë në dispozicion këstin 2, dhe duke njoftuar huamarrësin me shkrim që kësti 2 është zotuar.

Paragrafi 2.02. Shprehjet tjera financiare të kredisë

(a) Do të ketë një maksimum prej 1 (një) tërheqjeje në lidhje me çdo përdorim të fondeve të kredisë për secilin nën-huamarrës të pranueshëm.

(b) Shuma minimale e parapagimit do të jetë 500,000 Euro (pesëqind mijë euro).

(c) Shuma minimale e anulimit do të jetë 500,000 Euro (pesëqind mijë euro).

(d) Datat e pagesës së kamatës do të jenë 16 nëntor dhe 16 maj i secilit vit.

(e) (1) Huamarrësi do të shlyejë kredinë në katër këste të barabarta (ose sa më të barabarta të jetë e mundur) gjashtëmujore në 16 nëntor dhe 16 maj të çdo viti, me datën e parë të shlyerjes së kredisë që është 16 nëntor 2021 dhe datën e fundit të shlyerjes së kredisë që është 16 maj 2023.

(2) Pavarësisht nga sa u tha më lart, në rast se (i) huamarrësi nuk tërheq të gjithë shumën e kredisë para datës së parë të shlyerjes së kredisë të specifikuar në këtë paragraf 2.02. (e), dhe (ii) Banka zgjat datën e fundit të disponueshmërisë së specifikuar në paragrafin 2.02. (f) më poshtë deri në një datë e cila bie pas kësaj date të parë të shlyerjes së kredisë, atëherë shuma e secilës tërheqje të bërë në ose pas datës së parë të shlyerjes së kredisë do të ndahet për shlyerje në shuma të barabarta me disa data të ndryshme të shlyerjes së kredisë, e që i bie pas datës së një tërheqje të tillë (me Bankën që rregullon shumat e ndara aq sa është e nevojshme për ti arritur të gjithë numrat në secilin rast). Kohë pas kohe, banka do të njoftojë huamarrësin për ndarjet e tilla.

(f) Data e fundit e disponueshmërisë do të jetë

(i) sa i përket këstit 1, data që bie 6 muaj pas datës së kësaj marrëveshjeje, ose një datë e tillë e mëvonshme që banka në diskrecionin e saj mund ta krijojë dhe njoftojë huamarrësin në, dhe

(ii) sa i përket kështit 2, më e hershmja ndërmjet (a) datës që bie 6 muaj pas datës së disponueshmërisë së kështit 2, dhe (b) data që bie 12 muaj pas datës së kësaj marrëveshjeje, ose një datë e tillë e mëvonshme që Banka sipas diskrecionit të saj mund të krijojë dhe të njoftojë huamarrësin.

(g) Norma e tarifës së zotimit do të jetë 0.5% për vit.

(h) Kredia i nënshtrohet një norme të ndryshueshme të kamatës, në pajtim me dispozitat e paragrafit 3.04 (b) të kushteve dhe shprehjeve standarde.

Paragrafi 2.03. Tërheqjet

Shuma e disponueshme mund të tërhiqet kohë pas kohe në përputhje me dispozitat e planit 2 për të financuar (1) detyrimet afatshkurtra të pagueshme brenda 12 muajve nga data marrëveshjes relevante të nën-kredisë, ose, nëse paguhen para nënshkrimit të marrëveshjes së nën-kredisë, brenda 12 muajve nga data e pagimit të tyre, e cila do të jetë jo më parë se 1 maj 2020 për të mbuluar, mes tjerash, pagesa për furnizuesit, të punësuarit (në lidhje vetëm me të punësuarit e nën-huamarrësve të pranueshëm të cilët janë ose ndërmarrje në pronësi të shtetit që ofrojnë shërbime të rëndësishme të infrastrukturës ose ndërmarrje në pronësi komunale që ofrojnë shërbime të rëndësishme të infrastrukturës), apo pagesat, që të vazhdohen operacionet kryesore dhe mirëmbajtja sipas kontratave të prokuruaratash në vend, për përjashtimin e çdo pagese të tatimit ose pagese të shpenzimeve kapitale, dhe (2) Tarifën e shitjes.

NENI III – ZBATIMI I PROJEKTIT

Paragrafi 3.01. Marrëveshjet tjera afirmative të projektit

Përveç ndërmarrjeve të përgjithshme të përcaktuara në nenin IV të kushteve dhe shprehjeve standarde, huamarrësi, përveç nëse Banka pajtohet ndryshe, do të:

- (a) Vë në dispozicion të nën-huamarrësve të pranueshëm, sipas marrëveshjes (eve) të kredisë subsidiare në formë dhe substancë të kënaqshme për bankën, të ardhurat e kredisë me kushte dhe afate të pranueshme për bankën;
- (b) Kërkojë ta vë kredinë në dispozicion për të gjithë nën-huamarrësit e pranueshëm në baza të barabarta me nën-huamarrësit e pranueshëm më të këqinj të prekur e që marrin qasje me prioritet në fondet e kredisë;
- (c) Ushtrijë të drejtat e tij në bazë të marrëveshjes (-ve) së kredisë subsidiare në atë mënyrë që ti mbrojë interesat e huamarrësit dhe të bankës, të pajtohet me dispozitat e kësaj marrëveshjeje dhe të përmbush qëllimet për të cilat është marrë kredia;
- (d) Mos (dhe të sigurojë që nën-huamarrësi relevant i pranueshëm, nuk ka), përveç kur Banka pajtohet, caktojë, ndryshojë, shfuqizojë ose heqë dorë nga ndonjë dispozitë e marrëveshjes (-ve) së kredisë subsidiare;
- (e) Detyrojë nën-huamarrësin relevant të pranueshëm që ti kryejë të gjitha detyrimet e tij sipas marrëveshjes (eve) subsidiare të kredisë;

- (f) Mbajë ekzistencën e korporatës së nën-huamarrësve të pranueshëm në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi;
- (g) Mos hyjë në ndonjë transaksion ose seri transaksionesh (pavarësisht nëse ndërlidhen apo jo, dhe nëse janë vullnetare ose të pavullnetshme) për të shitur drejtpërdrejtë ose tërthorazi, transferimin ose shpërndarjen e pjesëmarrjes së tij (ose ndonjë pjesë të tij) në kapitalin themelor të nën-huamarrësve të pranueshëm, përfshirë mënyrën e privatizimit ose ndryshe;
- (h) Sigurojë shqyrtimin nga Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit e projektligjit për ndërmarrjet në pronësi publike dhe për të marrë ratifikimin parlamentar për një ligj të tillë të rishikuar, sa më shpejtë të lejojnë kushtet, por jo më vonë se data e fundit e ripagimit të kredisë;
- (i) Me mbështetjen e ndihmës teknike të ofruar nga banka, zhvillojë dhe miratojë gjatë kohëzgjatjes së kredisë, një politikë të pronësisë shtetërore për ndërmarrjet në pronësi publike bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare;
- (j) Lehtësojë programin e ndihmës teknike që do të ofrohet nga banka, për:
 - (1) Ndërtimin e kapaciteteve për nën-huamarrësit e pranueshëm mbi praktikat e mira ndërkombëtare sa i përket çështjeve mjedisore dhe sociale në sektorin relevant;
 - (2) Mbështetjen e NZP në zhvillimin dhe monitorimin e sistemit i cili i plotëson standardet e bankës, gjatë kohëzgjatjes së projektit; dhe
 - (3) Zhvillimin e politikës shtetërore të pronësisë për ndërmarrjet në pronësi publike sipa praktikave më të mira ndërkombëtare;
- (k) Mos përdorë të ardhurat e kredisë për të financuar (i) çdo entitet ose individ të përjashtuar nga banka në bazë të politikës së zbatimit dhe procedurave ose në Listën e Konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara sipas ose (ii) kontratave me një subjekt që është në pronësi ose kontrollohet nga një "person i ekspozuar politikisht" siç përcaktohet nga Task Forca e Veprimit Financiar, ose i cili është "palë e ndërlidhur" siç përcaktohet nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 24, apo kur ekziston një konflikt aktual ose i dukshëm interesi midis palëve kontraktuese, për shmangien e dyshimit, asnjë nën-huamarrës i pranueshëm, kontraktor i rëndësishëm ose kontraktor jo-i rëndësishëm, ose kontraktor i lejuar i palës së tretë, nuk do të bjerë, për qëllime të kësaj kredie, brenda fushëveprimit të pikave (i) ose (ii).

Paragrafi 3.02. Njësia për zbatimin e projektit

Në mënyrë që të koordinojë, menaxhojë, monitorojë dhe vlerësojë të gjitha aspektet e zbatimit të Projektit, Huamarrësi, përveç nëse është rënë dakord ndryshe me Bankën, do të organizojë dhe në çdo kohë gjatë ekzekutimit të Projektit të operojë me një njësi të zbatimit të projektit i cili, për shmangien e dyshimit, është themeluar në dhe përfshirë, mes tjerash, personel nga njësi monitoruese për Ndërmarrjet në Pronësi Publike në Ministrinë e Ekonomisë dhe Mjedisit të Republikës së Kosovës.

Paragrafi 3.03. Prokurimi

- (a) Për qëllime të paragrafit 4.03 të kushteve dhe shprehjeve standarde, rregullat e prokurimit të BERZH-it nuk do të zbatohen.
- (b) Pavarësisht dispozitave të paragrafit (a) më lart, konsulentët që do të punësohen nga huamarrësi për të ndihmuar në kryerjen Pjesës B e projektit (përfshirë edhe ndihmën për NZP) do të zgjidhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafin V të rregullave të prokurimit të BERZH-it.
- (c) Kontratat për qëllime të paragrafit 3.03 (b) më lart do t'i nënshtrohen procedurave të rishikimit të përcaktuara në rregullat e prokurimit të BERZH-it dhe do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak nga banka.

Paragrafi 3.04. Marrëveshjet e pajtueshmërisë mjedisore dhe sociale

Pa kufizuar shumicën e paragrafëve 4.02(a), 4.04(a)(iii), dhe 5.02(c)(iii) të kushteve dhe shprehjeve standarde, dhe përveç nëse banka pajtohet ndryshe, huamarrësi do të:

- (a) Kryejë punën e tij në pajtim me kërkesat e caktuara të performancës;
- (b) Kryejë punën e tij në përputhje me të gjithë legjislacionin kombëtar të zbatueshëm mjedisor, social dhe shëndetësor dhe të sigurisë, si dhe rregulloret dhe standardet e punësimit në fuqi në Republikën e Kosovës;
- (c) Mos përdor të ardhurat e kredisë për të financuar ndonjë prej aktiviteteve të shënuara në shtojcën 1 (*Lista e përjashtimeve mjedisore dhe sociale e BERZH-it*) të politikës sociale dhe mjedisore të BERZH-it; dhe
- (d) Sigurojë që burimet e duhura të menaxhimit dhe personelit janë emëruar për zbatimin e procedurave mjedisore dhe sociale të monitorimit sa i përket nën-huamarrësve të pranueshëm.

Paragrafi 3.05. Konsulentët

(a) Për të ndihmuar në zbatimin e projektit, huamarrësi, përveç nëse është pajtuar ndryshe me bankën, të punësojë ose të bëjë që të punësohen, siç kërkohet, dhe të përdorë konsulentët, kualifikimet, përvoja dhe kushtet e referencës së të cilave janë të kënaqshme për bankën, përfshirë:

- (1) konsulentët për të ndihmuar në zbatimin e pjesës B të projektit; dhe
- (2) konsulentët për të ndihmuar NZP.

(b) Huamarrësi do ti ofrojë, pa tarifë, çdo konsulenti të angazhuar për të ndihmuar në çështjet në lidhje me projektin ose operacionet e huamarrësit të gjitha lehtësirat dhe mbështetjen e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre, përfshirë hapësirën për zyrë, pajisjet e fotokopjimit dhe furnizimet, shërbimet e sekretarisë dhe transportit, si dhe të gjitha dokumentet, materialet dhe informacionet e tjera që mund të jenë relevante për punën e tyre.

Paragrafi 3.06. Shpeshësia e raportimit dhe kërkesat e dorëzimit

(a) Duke filluar nga data efektive (e hyrjes në fuqi), deri sa shuma e plotë e kredisë të jetë shlyer ose anuluar, huamarrësi do t'i paraqesë bankës raporte vjetore mbi çështjet mjedisore dhe sociale që dalin në lidhje me huamarrësin ose projektin, siç përmendet në paragrafin 5.02 (c) (iii) të kushteve dhe shprehjeve standarde, brenda 90 ditëve nga mbarimi i vitit për të cilin raportohet. Raporte të tilla do të përfshijnë informata për çështjet specifike të mëposhtme:

- (1) informata mbi pajtueshmërinë nga huamarrësi me kërkesat e caktuara të performancës siç përshkruhet në paragrafin 3.04(a);
- (2) informata mbi mënyrën se si huamarrësi ka monitoruar pajtueshmërinë me kërkesat e caktuara të performancës nga çdo kontraktues i angazhuar për projektin dhe një përmbledhje e çfarëdo mospërputhjeje materiale nga një kontraktues i tillë me Kërkesat e caktuara të performancës dhe të çfarëdo masash të marra për të përmirësuar një mosrespektim të tillë;
- (3) informata mbi zbatimin e planit të angazhimit të palëve të interesuara dhe mekanizmin e ankesave të kërkuara nga kërkesa e caktuar e performancës 10, përfshirë një përmbledhje të ankesave të marra dhe se si u zgjidhën këto ankesa;
- (4) informata mbi pajtueshmërinë e huamarrësit me ligjet mjedisore dhe sociale në lidhje me projektin, përfshirë përshkrimin e çdo kërkesë, procedimi, urdhri ose hetimi të filluar ose të kërcënuar kundër huamarrësit, statusin e çdo autorizimi të kërkuar për projektin, rezultatet e çdo inspektimi i kryer nga çdo autoritet rregullator, çdo shkelje e ligjeve në fuqi, rregulloreve ose standardeve dhe çdo veprim përmirësues ose gjobë në lidhje me shkelje të tillë, një përmbledhje e çdo njoftimi material, raport dhe komunikim tjetër për çështjet mjedisore dhe sociale në lidhje me projektin të paraqitur nga huamarrësi për ndonjë autoriteti rregullator, dhe çfarëdo rrethanash të tjera që rrisin përgjegjësinë e huamarrësit për çdo çështje mjedisore dhe sociale;
- (5) informata mbi menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë dhe të dhënat e shëndetit dhe sigurisë në punë për projektin, përfshirë edhe nivelet e aksidenteve, incidenteve të humbura në kohë dhe humbjeve të afërta, çdo masë parandaluese ose lehtësuese të ndërmarrë ose planifikuar nga huamarrësi, çdo trajnim të stafit për shëndetin dhe sigurinë në punë, dhe çdo iniciativë tjetër në lidhje me menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë, të cilat janë zbatuar ose planifikuar nga huamarrësi;
- (6) një përmbledhje për çfarëdo ndryshimi në ligjet mjedisore dhe sociale që mund të ketë një efekt material në projekt;
- (7) kopjet e çdo informate mbi çështjet mjedisore dhe sociale, të cilat paraqiten periodikisht nga huamarrësi tek aksionarët e tij ose publiku i gjerë;

(b) Duke filluar nga data efektive (e hyrjes në fuqi), huamarrësi do të dorëzojë përmes NZP raportet periodike të projektit të përmendura në paragrafin 4.04 (a) (v) të kushteve dhe shprehjeve standarde në bazë gjysmë vjetore, brenda 60 ditëve nga mbarimi i periudhës për të cilën raportohet, deri sa të ketë përfunduar projekti. Raporte të tilla do të përfshijnë karakteristikat e mëposhtme specifike:

(1) Detaje mbi përdorimin e të ardhurave të kredisë, që konfirmojnë, mes tjerash, pajtueshmërinë me kriteret e pranueshmërisë për përdorim të fondeve të kredisë për çdo nën-kredi të ndarë për një nën-huamarrës të pranueshëm, duke përfshirë një përmbledhje të vendimit për ndarjen e një nën-kredie të tillë, shumën e papaguar të kredisë në datën e raportimit, dhe çdo çështje tjetër që mund të ketë dalë në lidhje me përdorimin e fondeve të kredisë dhe nën-huamarrësin përkatës;

(2) Informatat e përgjithshme si më poshtë:

(A) ndryshimet kryesore të personelit në stafin e NZP ose konsulentët;

(B) çështjet që mund të ndikojnë në shpenzimet e projektit; dhe

(C) çdo zhvillim ose aktivitet që ka të ngjarë të ndikojë në qëndrueshmërinë ekonomike të ndonjë pjese të projektit.

(3) Pasqyrat financiare që tregojnë detaje të shpenzimeve të ndodhura për të ardhurat e kredisë gjatë periudhës për të cilën raportohet, së bashku me një pasqyrë që tregon:

(A) vlerësimet origjinale të kostos;

(B) vlerësimet e rishikuara të kostos, nëse ka ndonjë, me arsye për ndryshime;

(C) shpenzimet e vlerësuara origjinale dhe shpenzimet aktuale deri më tani;

(D) arsyet e ndryshimeve të shpenzimeve aktuale deri më tani nga shpenzimet fillestare të vlerësuara deri më sot; dhe

(E) shpenzimet e vlerësuara për tremujorët e mbetur të vitit.

(4) Një deklaratë e shkurtër e statusit të pajtueshmërisë me secilën prej elementeve të përfshira në këtë Marrëveshje.

(c) Menjëherë pas ndodhjes së ndonjë incidenti ose aksidenti në lidhje me Huamarrësin ose Projektin i cili mund të ketë një efekt negativ në mjedisin, punëtorët, shëndetin, sigurinë publike ose profesionale, Huamarrësi do të informojë Bankën dhe menjëherë pas kësaj të ia jap njoftimin Bankës duke specifikuar natyrën e incidentit ose aksidentit të tillë dhe çdo hap që Huamarrësi do të ndërmerret për të korrigjuar të njëjtën. Kur një incident përfshin një informacion të ndjeshëm në lidhje me një person ose ndonjë rrezik të hakmarrjes, njoftimi fillestar për Bankën nuk duhet të përfshijë detaje të identitetit të personave të përfshirë, duke mos kufizuar gjeneraliteti që u përmend me lartë.

(1) një incident ose aksident ka lidhje me Projektin nëse ndodh në ndonjë vend të përdorur për Projektin, ose nëse është shkaktuar nga punëtorët e projektit dhe/ose objektet, pajisjet, automjetet ose anijet e përdorura që kanë të bëjnë me

Projektin (edhe nese jane perdorur ose jo në ndonjë vend të Projektit dhe nëse janë duke u përdorur nga persona të autorizuar ose të paautorizuar);

(2) një incident ose aksident konsiderohet të ketë një efekt domethenes negativ në mjedis ose shëndetin publik, profesionin ose sigurinë nëse:

(A) çdo ligj i zbatueshëm kërkon njoftimin e një incidenti ose aksidenti të tillë për çdo autoritet qeveritar,

(B) një incident ose aksident i tillë përfshin vdekjen e ndonje personi (pavarësisht nëse ky person është i punësuar ose jo nga Huamarrësi),

(C) më shumë se një person (nëse personat e tillë janë të punësuar ose jo nga Huamarrësi) ka marrë një dëmtim serioz që kërkon shtrimin në spital,

(D) një incident i tillë përfshin dhunën dhe ngacmimin, bulizmin, frikësimin dhe/ose shfrytëzimin, duke përfshirë çdo formë të dhunës me bazë gjinore;

(E) një incident i tillë përfshin punë të detyruar për fëmijët në lidhje me Projektin; ose

(F) një incident ose aksident i tillë është bërë, ose ka të ngjarë të bëhet, e njohur për publikun, qoftë përmes mediave ose në ndonjë formë tjetër.

(d) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo protestë apo petition të rëndësishëm nga punëtorët ose anëtarët e publikut të drejtuar në lidhje me Huamarrësin ose Projektin i cili mund të ketë një efekt negativ material mbi Huamarrësin ose Projektin ose që është bërë, ose ka të ngjarë të bëhet, e njohur për publikun përmes njoftimit nga mediat ose në ndonjë formë tjetër. Brenda dhjetë ditësh pas çdo njoftimi të tillë, Huamarrësi do të paraqesë Bankës një raport të kënaqshëm duke specifikuar rezultatin e hetimit të Huamarrësit në një protestë të tillë, dhe çdo hap të ndërmarrë, ose të propozuar për tu marrë nga Huamarrësi për të zgjidhur çështjet e ngritura në proteste apo petition.

(e) Huamarrësi do të njoftojë menjëherë Bankën për çdo propozim për të ndryshuar, pezulluar ose shfuqizuar çdo dispozitë materiale të Statutit të Nën Huamarrësve të Pranueshem dhe këshillojë Bankën për çdo ndryshim material në ekzistencën e tyre të korporatave.

NENI IV – Marrëveshjet financiare

Paragrafi 4.01. Regjistrat financiarë dhe raportet

(a) Huamarrësi, në lidhje me Nën Huamarrësit e Pranueshem, miremban procedurat, regjistrimet dhe llogaritë e duhura për të reflektuar, në përputhje me Parimet e Pergjithshme të Pranuarat të Kontabilitetit, operacionet, burimet dhe shpenzimet në lidhje me Projektin dhe të monitorojë dhe regjistrojë progresin e Projektit (përfshirë kostot e tij dhe përfitimet që do të nxirren prej tij).

(b) Huamarrësi do të:

(1) ketë të dhënat dhe llogaritë e përmendura në Paragrafin 4.01 (a) për secilin vit fiskal të audituar nga auditorë të pavarur në përputhje me Parimet e Përgjithshme të Pranuara të Kontabilitetit;

(2) ti paraqesë Bankës sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se gjashtë muaj pas përfundimit të çdo viti Fiskal, raportin e një kontrolli të tillë nga auditorë të tillë të një qëllimi të tillë dhe me detaje të tilla që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme; dhe

(3) të lejojnë përfaqësuesit e Bankës të vizitojnë ambientet ku zhvillohet biznesi i Huamarrësit dhe ti ofrojnë Bankës informacione të tjera në lidhje me përdorimin e fondeve të Kredise, regjistrimeve dhe llogarive të tilla për përdorimin e të ardhurave të kredise dhe auditimit, pasi Banka kohë pas kohe mund ti kërkojë në mënyrë të arsyeshme.

NENI V - PEZULLIMI ; PËRSHPEJTIMI

Paragrafi 5.01. Pezullimi

Në kuader të paragrafit 7.01(a)(xvii) me poshtë janë specifikuar kushtet dhe shprehjet standarde:

(a) korniza legjislative dhe rregullatore e zbatueshme për nën-huamarrësit e pranueshem në territorin e huamarrësit do të ndryshohet, pezullohet, shfuqizohet, ose heqet dorë në atë mënyrë që do të aprovohet me shkrim nga Banka;

(b) statuti i nën-huamarrësve të pranueshem do të ndryshohet, pezullohet, shfuqizohet, ose heqet dorë nëse do të ndikonte në projekt ose në aftësinë e tyre për të kryer ndonjë nga detyrimet e tyre në bazë të Marrëveshjes (-ve) Subsidiare të Kredise përkatëse.;

(c) Përveç nëse banka pajtohet ndryshe, kontrolli i nën-huamarrësve të pranueshëm do të transferohet tek një palë tjetër përveç huamarrësit ose një entiteti të kontrolluar përfundimisht nga huamarrësi; ose

(d) Nën-Huamarrësi i Pranueshëm do të ketë dështuar në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve të tij në bazë të Marrëveshjes (-ve) Subsidiare të Kredise përkatëse.

Paragrafi 5.02. Përshpejtimi i Maturitetit

Ne kuader të paragrafit 7.06 (f) janë specifikuar kushtet dhe shprehjet standarde:

(a) çdo ngjarje e specifikuar në Paragrafin 5.01 do të ketë ndodhur dhe do të vazhdojë për gjashtëdhjetë (60) ditë pasi njoftimi t'i jetë dhënë Huamarrësit.

NENI VI – EFEKTIVITETI

Paragrafi 6.01. Kushtet precedente të efektivitetit

Ne kuader te paragrafit 9.02 (c) jane specifikuar Kushtet dhe shprehjet standarde si kusht shtesë për efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje:

(a) Parlamenti i Republikës së Kosovës e ka ratifikuar këtë Marrëveshje, i cili ratifikim është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe Huamarrësi i ka dhënë Bankës dëshmi të kënaqshme të saj.

Paragrafi 6.02. Kushtet paraprijëse për të gjitha tërheqjet e kështit 1

Pa paragjykuar dispozitat e Paragrafit 6.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe Paragrafeve 9.01, 9.02 dhe 9.03 të kushteve dhe shprehjeve standarde në lidhje me efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje, detyrimi i Bankës për të bërë të gjitha tërheqjet në lidhje me Këstit 1 do ti nënshtrohet përmbushjes paraprake, në formë dhe substancë të kënaqshme për Bankën, ose me diskrecionin e vetëm të Bankës, heqjen dorë, qoftë tërësisht apo pjesërisht dhe nëse është subjekt i kushtezimeve ose jo-kushtezimeve te precedentëve të mëposhtëm:

(a) Marrëveshja (et) subsidare e kredise ndërmjet Huamarrësit dhe nën-huamarrësit të pranueshëm në formë dhe substancë e pranueshme për Bankën do të nënshtrohen për shumën përkatëse të disbursimit dhe kopjet e tyre do ti sigurohen Bankës; dhe

(b) dhënia nga Huamarrësi për Bankën e një dokumentacioni mbështetës të kënaqshëm që dëshmon respektimin e kriterëve të pranueshmërisë për përdorimin e fondeve të kredisë nga nën-huamarrësit e pranueshëm për shumën përkatëse të disbursuar, dhe

c) sa i përket tërheqjes së parë të kështit 1, angazhimi nga huamarrësi i një auditori të pavarur, i kënaqshëm për Bankën dhe sipas kushteve të referencës të pranueshme për Bankën, për të vlerësuar pajtueshmërinë e huamarrësit me kriteret e pranueshmërisë për përdorimin e fondeve të kredisë sa i përket shumave të kështit 1.

Paragrafi 6.03. Kushtet paraprijëse të disponueshmërisë dhe tërheqjeve të Kështit 2

(a) Kësti 2 do të vihet në dispozicion ne diskrecion te plotë të Bankës. Përcaktimi i tillë do ti nënshtrohet, por jo kufizohet në kushtet e mëposhtme të precedentit që janë përmbushur ne nivelin e kënaqshem te Bankës:

(1) të paktën 80% (tetëdhjetë për qind) e Kështit 1 do të duhej tërhequr;

(2) vlerësim i kënaqshëm nga Banka ne lidhje me perputhshmerine e huamarrësit me kriteret e pranueshme për përdorimin e fondeve të kredisë mbi ndarjen e kredive për nën-huamarrësit e pranueshëm sipas kështit 1; dhe

(3) vlerësim i kënaqshëm nga Banka ne lidhje me perputhshmerine e Huamarrësit me Kërkesat e përcaktuara të performancës në lidhje me Këstin 1.

(4) miratimin nga banka për një caktim të bashkëpunimit teknik për zhvillimin e një politike të pronësisë shtetërore mbi ndërmarrjet në pronësi publike; dhe

(5) angazhimi nga huamarrësi i një auditori të pavarur i kënaqshëm për bankën dhe sipas termave të references të pranueshme për bankën, për të vlerësuar pajtueshmërinë e huamarrësit me kriteret e pranueshmërisë për përdorimin e fondeve të kredisë në lidhje me shumat e kështit 2 për t'u disbursuar, sipas rastit, në llogari bankare të dedikuara të përcaktuara nga secili nën-huamarrës i pranueshëm.

(b) Detyrimi i Bankës për të bërë tërheqje në lidhje me Kestin 2 do të jete subjekt i përmbushjes paraprake, në formë dhe substancë të kënaqshme për Bankën, ose në diskrecionin e vetëm të Bankës në heqjen dorë, qoftë në tërësi ose pjesërisht dhe qoftë nëse është subjekt i kushtezimeve dhe jo-kushtezimeve të precedentëve të kushteve të paraqitura më poshtë:

(1) në lidhje vetëm me tërheqjen e parë, kushtet e listuara në Paragrafin 6.03 (a) më lartë; dhe

(2) në lidhje me të gjitha tërheqjet, përfshirë tërheqjen e parë:

i. Marrëveshja (et) e kredise subsidiare ndërmjet Huamarrësit dhe Nën-Huamarrësit të pranueshëm në formë dhe substancë të pranueshme për Bankën do të nënshkruhet/en për shumën përkatëse të disbursimit dhe kopjet e saj do të jepen Bankës; dhe

ii. Huamarrësi do të sigurojë Bankës një dokumentacion mbështetës të kënaqshëm që dëshmon përputhshmerinë me kriteret e pranueshmërisë për përdorimin e fondeve të kredisë nga nën-huamarrësit e pranueshëm për shumën përkatëse të disbursuar.

Paragrafi 6.04. Mendimi Ligjor

Në kuader të paragrafit 9.03 (a) të kushteve dhe shprehjeve standarde, mendimi ose mendimet e këshilltarit do të ipen në emër të Huamarrësit nga drejtuesi i departamentit ligjor të Ministrisë të Financave të Republikës së Kosovës.

Paragrafi 6.05. Ndërprerja për shkak të deshtimit për t'u bërë efektiv

Data e 180 ditëve pas datës së kësaj Marrëveshjeje është specifikuar për qëllime të Paragrafit 9.04 të kushteve dhe shprehjeve standard.

NENI VII – TË NDRYSHME

Paragrafi 7.01. Njoftimet

Adresat e paraqitura më poshtë janë bërë për qëllim të paragrafit 10.01 në lidhje me Shprehjet dhe Kushtet;

Për Huamarrësin:

Ministria e Financave
Qeveria e Republikës së Kosovës
Bulevardi Nëna Terezë
10000 Prishtine
Kosove

Për vemendje të: Ministrise së Financave
Faksi: +38138213113

Për Bankën:

Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londer EC2A 2JN
Mbreteri e Bashkuar

Per vemendje te: Departamentit per Administrimin e Operacioneve

E-mail: oad@ebrd.com

NË DËSHMI TË KËSAJ, palët e paraqitura këtu, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në [katër] kopje dhe të dorëzohet në Prishtinë, Republika e Kosovës, që nga dita dhe viti i parë i shkruar më lart.

REPUBLIKA E KOSOVËS

Nga: _____

Emri:

Titulli:

BANKA EVROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga: _____

Emri:

Titulli:

PLANI 1 - PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

1. Qëllimi i projektit është të ndihmojë Huamarrësin në sigurimin e fondeve të likuiditetit emergjent për ofruesit e infrastrukturës vitale të prekur nga kriza pandemike COVID-19.

2. Projekti përbëhet nga Pjesët e paraqitura me poshte, duke iu nënshtruar modifikimeve të tilla për të cilat mund të bien dakord here pas here nga Banka dhe Huamarrësi

Pjesa A: Financimi i detyrimeve afatshkurtra që duhet të paguhen brenda 12 muajsh nga data e Marrëveshjes përkatëse të Kredise ose, nëse paguhen para nënshkrimit të Marrëveshjes së Kredise, brenda 12 muajve nga data e pagimit të tyre e cila nuk do të jetë më herët se 1 maji 2020, për të mbuluar, ndër të tjera, pagesat për furnitorët, punonjësit (në lidhje vetëm me punonjësit e Nën-Huamarrësve të Pranueshem të cilët janë ose ndërmarrje shtetërore që ofrojnë shërbime të rëndësishme të infrastrukturës ose ndërmarrje në pronësi të përbashkët që ofrojnë shërbime të rëndësishme të infrastrukturës), ose pagesa për të vazhduar operacionet thelbësore dhe mirëmbajtjen sipas kontratave të prokuruarash tashmë në vend, deri në përjashtimin e çdo pagese të Taksave ose pagesave të shpenzimeve kapitale;

Pjesa B: (i) Programi për ndërtimin e aftësive mjedisore dhe sociale të nën-huamarrësve të Pranueshem në baze të praktikës së mirë ndërkombëtare; (ii) mbështetje për NZP në zhvillimin dhe zbatimin e një sistemi monitorimi që plotëson standardet e bankës, për kohëzgjatjen e projektit; dhe (iii) zhvillimi i një politike të pronësisë shtetërore për ndërmarrjet në pronësi publike bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare.

3. Projekti pritet të përfundojë deri më 16 Maj 2023.

PLANI 2 - KATEGORITË DHE TËRHEQJET

1. Shtojca e bashkangjitur në këtë plan përcakton kategoritë, shumën e kredise të alokuar për secilën kategori dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen në secilën kategori.
2. Pavarësisht nga parashikimet e paragrafit 1 më lart, asnjë tërheqje nuk do të bëhet në lidhje me shpenzimet e bëra para datës së Marrëveshjes së Kredise Ndhmëse, përveç se tërheqjet deri në shumën totale të Kestit 1 dhe në lidhje me Kestin 1 mund të bëhen vetëm për qëllime të financimit të pagesave nga Huamarrësi tek Nën-Huamarrësit e Pranueshem (në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, përfshirë, pa kufizim, përmbushjen e plotë të Kritereve të Pranueshme) për llogari të shpenzimeve të paguara para datës së Marrëveshjes përkatëse të Kredise por pas 1 majit 2020.

Shtojca e Planit 2

Kategoria	Shuma e kredise e alokuar në valuten e kredisë	Përqindja e shpenzimeve që duhet të financohen
(1) Pjesa A	29,700,000 EUR	Deri në 100% të shpenzimeve duke përjashtuar taksat
(2) Tarifa Front End	300,000 EUR	100%
Totali	30,000,000 EUR	

PLANI 3 – FORMULARI I MARRËVESHJES SUBSIDIARE TË KREDISË

MARRËVESHJA SUBSIDIARE E KREDISË
(VISP: Kredi Likuide emergjente për infrastrukturën vitale të Kosovës)

Ndërmjet

REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Dhe

[*Emri i Nën-huamarresit të pranueshëm*]

Data [_____]

TABELA E PËRMBAJTJES

NENI I - KUSHTET DHE SHPREHJET STANDARDE; PËRKUFIZIMET	5
Paragrafi 1.01.Përfshirja e kushteve dhe shprehjeve standarde.....	5
Paragrafi 1.02 Përkufizimet	5
Paragrafi 1.03.Interpretimi	12
 NENI II - AFATET KRYESORE TË KREDISË	 12
Paragrafi 2.01.Shuma dhe valuta	12
Paragrafi 2.02.Afatet tjera financiare te kredise	12
Paragrafi 2.03.Tërheqjet	13
 NENI III - EKZEKUTIMI I PROJEKTIT	 14
Paragrafi 3.01.Marrëveshjet tjera afirmative të projektit.....	13
Paragrafi 3.02.Njësia e zbatimit të projektit	14
Paragrafi 3.03.Prokurimi	15
Paragrafi 3.04. Marrëveshjet e mjedisit dhe përputhshmeria sociale	15
Paragrafi 3.05.Konsulentet	15
Paragrafi 3.06. Shpeshtësia e raportimit dhe dorëzimet	16
 NENI IV - MARRËVESHJET FINANCIARE	 18
Paragrafi 4.01.Regjistrat financiarë dhe raportet	18
 NENI V - PEZULLIMI; PËRSHPEJTIMI; ANULIMI.....	 19
Paragrafi 5.01.Pezullimi	19
Paragrafi 5.02.Përsheptimi i maturitetit.....	19
 NENI VI - EFEKTIVITETI	 20
Paragrafi 6.01.Kushtet precedente drejt efektivitetit	20
Paragrafi 6.02.Kushtet precedente ndaj tërheqjeve të Kestit 1	20
Paragrafi 6.03. Kushtet paraprake të disponueshmërisë dhe tërheqjeve të Kestit 2	20
20	
Paragrafi 6.04.Mendimi Ligjor	21
Paragrafi 6.05.Ndërperja për shkak të deshtimit për tu bërë efektiv	21
 NENI VII - TË NDRYSHME	 21
Paragrafi 7.01.Njoftimet	21

MARRËVESHJA SUBSIDIARE E KREDISË

MARRËVESHJA, me date _____ ndermjet **REPUBLIKËS SË KOSOVËS** ("Republika e Kosovës") dhe [*Emri i Nen-Huamarrësve te Pranueshëm*] ("Nen-Huamarrësi i Kualifikuar").

HYRJE

PËRMES kësaj marrëveshje të kredisë të datës [•] 2020 ("Marrëveshja e Kredisë") ndermjet Republikës së Kosovës si huamarrës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim si huadhënës ("Banka"), Banka pranoi të vë në dispozicion të Huamarrësit një kredi ("Kredi") sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen e Kredisë;

PËRMES, kësaj marrëveshje të kredisë, banka ka kërkuar që huamarrësi të hyjë në një marrëveshje subsidare të kredisë me nën-huamarrësin e pranueshëm;

Duke marrë parasysh atë çka u tha më sipër, Republika e Kosovës dhe nën-huamarrësi i pranueshëm kanë rënë dakord të hyjnë në këtë marrëveshje, me anë të së cilës të ardhurat e kredisë do t'i vihen në dispozicion nën-huamarrësit të pranueshëm për qëllimet e zbatimit të projektit duke ku nën-huamarrësi i pranueshëm do të përfitoj në mënyrë direkte dhe indirekte.

SI PËRFUNDIM, palët janë pajtuar si në vijim;

NENI I – INTERPRETIMI

Paragrafi 1.01. Përkufizimi

Kudo që përdoret në këtë marrëveshje ose në planet e paraqitura këtu, përveç kur përcaktohet ndryshe dhe në atë masë që lejon konteksti, shprehjet e kapitalizuara të përcaktuara në hyrje kanë kuptimet përkatëse të përshkruara në të, shprehjet e kapitalizuara të përcaktuara në marrëveshjen e kredise kanë kuptimet përkatëse në atë masë sa lejon konteksti, përderisa shprehjet e mëposhtme të kapitalizuar kanë këtë kuptim:

"Bashkëpunetorët"	ka kuptimin që i jepet asaj në Politikën e Zbatimit dhe Procedurave.
"Praktika e ndaluar"	ka kuptimin që i është dhënë asaj në Politikën e Zbatimit dhe Procedurave
"Projekti"	ka kuptimin që i është dhënë asaj në Marrëveshjen e Kredise.
Mekanizmi i ankesave të projektit	“nënkupton mekanizmin e llogaridhënies së Bankës siç përcaktohet në Rregulloren e Mekanizmit të Ankesave të Projektit (PCM) të datës maj 2014, pasi këto rregulla mund të ndryshohen, plotësohen ose zëvendësohen herë pas here.
"Nën-kredi"	ka kuptimin që i është dhënë asaj nën Paragrafin 3.01 (<i>Shuma e Kredise</i>).

Paragrafi 1.02. Titujt

Titujt e neneve dhe paragrafëve, si dhe tabela e përmbajtjeve, janë inkorporuar vetëm për qëllime të referencës dhe nuk do të përdoren për të interpretuar këtë marrëveshje.

Paragrafi 1.03 Njohjet/pranimet

Nën-huamarrësi i pranueshëm pranon se ka marrë një kopje të marrëveshjes së kredisë.

NENI II - PËRFAQËSIMET DHE GARANCIONET

Paragrafi 2.01. Përfaqësimet në lidhje me këtë marrëveshje

Nën-Huamarrësi i Pranueshëm përfaqëson dhe garanton si më poshtë:

(a) ka fuqinë për të hyrë në këtë Marrëveshje;

(b) kjo Marrëveshje është autorizuar dhe ekzekutuar siç duhet nga Nën-Huamarrësi i Pranueshëm dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ligjrisht detyrues të Nën-Huamarrësit të Pranueshëm, i zbatueshëm në përputhje me kushtet e tij/saj

(c) lidhja e kësaj Marrëveshjeje dhe pajtueshmëria me kushtet e saj nuk do të rezultojë në shkelje të statutit të saj ose të ligjeve ose të ndonjë marrëveshjeje ose instrumenti në të cilin është palë;

(d) nuk është, dhe nuk do të jetë në asnjë kohë, një subject i refuzuar nga Banka në bazë të politikës së zbatimit dhe procedurave ose në Listën e Konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nën Kapitullin VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

(e) fondet e vena në dispozicion të saj nga Republika e Kosovës në bazë të kësaj Marrëveshjeje nuk do të financojnë (i) ndonjë entitet ose individ të refuzuar nga Banka në bazë të Politikës së Zbatimit dhe Procedurave ose në Listën e Konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara ose (ii) kontratat me një entitet që ka një aksionar i cili është një “person i ekspozuar politikisht” siç përcaktohet nga Task Forca e Veprimit Financiar, është një “palë e nderlidhur” siç përcaktohet nga Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit 24, ose ku ekziston një konflikt aktual ose i dukshëm i interesit midis palëve kontraktuese; për shmangien e dyshimit, asnjë Nën-Huamarrës i Pranueshëm, Kontraktues Substancial, Kontraktues Jo-Substancial ose Kontraktues i lejuar i Palës së Tretë, nuk do të bjerë, për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, brenda fushes së veprimit (i) ose (ii); dhe

(f) nuk është në kundërshtim me ndonjë ligj të zbatueshëm dhe aktualisht në fuqi. Është në përputhje me të gjitha ligjet e zbatueshme në lidhje me pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit. As Nën-Huamarrësi i Pranueshëm dhe as ndonjë zyrtar, drejtor, punonjës i autorizuar, bashkëpunëtorë, agjentë ose përfaqësues të Nën-Huamarrësit të Pranueshëm nuk ka kryer ose ka qene i angazhuar në ndonjë Praktikë të Ndaluar në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo Marrëveshje.

NENI III – KREDIA SUBSIDIARE

Paragrafi 3.01. Shuma e nën-kredisë

Republika e Kosovës pranon ti huazojë Nën-Huamarrësit të Pranueshëm, sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara ose të përmendura në këtë Marrëveshje, një shumë totale Euro [shënoni shumën në shifra] ([shënoni shumën me shkronja¹]) (“Nën-Kredi”).

Paragrafi 3.02. Alokimi i Tërheqjeve

(a) Në varësi të Paragrafit 3.03 (Përdorimi i të Ardhurave), shumën e disponueshme të Nën-Kredisë mund të tërhiqet herë pas here dhe të alokohet në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje për shpenzimet e bëra me qëllim të zbatimit të Projektit, ku Nën-

¹ Kjo duhet të jetë në çdo rast maksimumi i 5,000,000 EUR në mënyrë që të jete në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Kredisë.

Huamarrësi i Pranueshëm do te perfitoj drejteperdrejte, ose, sipas rastit, një Kontraktues Substancial, një Kontraktues Jo-Substancial ose një Kontraktues i Lejuar i Palës së Tretë.

(b) Ne lidhje me çdo tërheqje, Ministria e Financave e Republikës së Kosovës dhe Nën-Huamarrësi i pranueshëm do ti dorëzojnë Bankës një vërtetim origjinal, duke specifikuar, mes të tjerash, shumën e shpenzimeve që do të financohen nga secila tërheqje, në formën e Planit 1 (Formulari i vërtetimit të disbursimit të nën-kredisë, deklarates dhe konfirmimit) dhe e kënaqshme ne thelb për Republikën e Kosovës dhe Bankën.

(c) Në përputhje me Paragrafin 6.03 (a) (5) të Marrëveshjes së Kredise, Fondet e Kredise në lidhje me Kestin 2 do të shpërndahen në llogari bankare të dedikuara dhe përcaktuara nga secili Huamarrës i Pranueshem.

Paragrafi 3.03. Përdorimi i të ardhurave

Fondet e vendosura në dispozicion të Republikës së Kosovës për Nën-Huamarrësin e Pranueshem sipas kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen vetëm dhe ekskluzivisht për të përmbushur detyrimet afatshkurtra te pagueshme brenda 12 muajve nga data e kësaj Marrëveshjeje ose, nëse paguhen para datës së kësaj Marrëveshjeje, brenda 12 muajve nga data e pagimit të tyre, e cila nuk duhet të jetë më e hershme se 1 maj 2020, për të mbuluar, ndër të tjera, pagesat për furnitorët, punonjësit (në lidhje vetëm me punonjësit e Nën-Huamarrësve të Pranueshem që janë ose ndërmarrje në pronësi shtetërore që ofrojnë shërbime të rëndësishme të infrastrukturës ose ndërmarrje në pronësi të komunes që ofrojnë shërbime thelbësore të infrastrukturës), ose pagesa për të vazhduar operacionet thelbësore dhe mirëmbajtjen sipas kontratave të prokuruar tashmë në vend, për përjashtimin e çdo pagese të Taksave ose pagesa të shpenzimeve kapitale, në përputhje të plotë dhe të rreptë me Dispozitat e Marrëveshjes së Kredise.

Paragrafi 3.0 [•]. [•]

[Palët e kësaj Marrëveshjeje për të prezantuar kushtet përkatëse tregtare të dakorduara ndërmjet tyre për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje, të tilla si norma e interesit, orari i ripagimit të kredise², tarifrat,]

NENI IV - EKZEKUTIMI I PROJEKTIT

Paragrafi 4.01. Obligimet e Projektit

Republika e Kosovës do te obligoj Nën Huamarrësin e Pranueshëm të kryejë Projektin në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Kredise. Për këtë qëllim:

(a) Republika e Kosovës do te ushtroj të drejtat e saj sipas kësaj Marrëveshjeje në atë mënyrë që të mbrojë interesat e saj dhe ato të Bankës, të respektojë dispozitat e Marrëveshjes së Kredise dhe të përmbushë qëllimet për të cilat është dhënë Kredia;

² Orari i nën-kredise duhet të jetë në çdo rast një periudhë minimale prej një viti ne menyre qe te jete ne perputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Kredise.

- (b) Republika e Kosovës dhe Nën-Huamarrësi i pranueshëm, përveç nese Banka pajtohet ndryshe, nuk do të caktojë, ndryshojë, shfuqizojë ose të heqë dorë nga ndonjë dispozitë të kësaj Marrëveshjeje;
- (c) Nën-Huamarrësi i Pranueshëm do të ruajë ekzistencën e tij korporative në përputhje me të gjitha ligjet në fuqi;
- (d) profili i integritetit të Nën-Huamarrësit të Pranueshem, para terheqjes duhet të jetë në përputhje me standardet e brendshme të Bankës, me një diskrecion të vetëm të Bankës për të de-selektuar aplikuesin përkatës;
- (e) në rastin kur të ardhurat e një nën-kredie do të përdoren nga një Nën-Huamarrës i Pranueshem , sic mund të jete komuna, një kompani në pronësi komunale, ose një ndërmarrje ne pronesi shtetërore jo korporative (siç vlerësohet nga Banka në diskrecion e vetëm të saj), për të bërë një pagesë substanciale, Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të sigurojë që Banka ka vlerësuar dhe aprovuar secilin Kontraktues të tillë Substancial para çdo tërheqje të nën-kredise, në përputhje me standardet e brendshme të Bankës, dhe se nje Kontraktues i tille ka hyrë në Formën e Ndërmarrjes së Integritetit në bazë të Planit 2 të kësaj Marrëveshjeje me Nën Huamarrësit e Pranueshem, me anë të ciles Kontraktori i tillë Substancial pajtohet, si kusht për marrjen e fondeve nën-huase, *ndër të tjera*, për zbatimin e Politikës së Zbatimit dhe Procedurave , si dhe të drejtat e hyrjes, auditimit dhe inspektimit të Bankës;
- (f) në rastin kur të ardhurat e një nën-kredie do të përdoren nga një Nën-Huamarrës i Pranueshem , sic mund të jete komuna, një kompani në pronësi komunale ose një ndërmarrje ne pronesi shtetërore jo- korporative (ashtu siç vlerësohet nga Banka në diskrecionin e saj të vetëm) për të bërë një Pagesë Jo-Substanciale, Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të sigurojë që Banka ka kryer Kontrollin Themelore të Integritetit për secilin Kontraktues Jo-Substancial dhe të konfirmojë pranueshmërinë e një Kontraktuesi të tillë Jo-Substancial, përpara çdo tërheqje të fondeve të nën-kredise si kusht për të marrë fondet e nën-kredise;
- (g) Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të sigurojë që fondet e vëna në dispozicion nga Republika e Kosovës për Nën-Huamarrësin e Pranueshem sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të financojnë (i) ndonjë entitet ose individ të refuzuar nga Banka në bazë të Politikës së Zbatimit dhe Procedurave ose në Listën e Konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara sipas Kapitullit VII të Kartës së Kombeve të Bashkuara ose (ii) kontratave me një entitet që ka një aksionar i cili është një “person i ekspozuar politikisht” siç përcaktohet nga Task Force e Veprimit Financiar, ose kush është një” palë e nderlidhur” siç përcaktohet me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 24, ose kur ekziston një konflikt interesi aktual ose i dukshëm midis palëve kontraktuese; për shmangien e dyshimit, asnjë Nën-Huamarrës i Pranueshem, Kontraktues Substancial, Kontraktues Jo-Substancial ose një Kontraktues i lejuar i Palës së Tretë, nuk do të bjerë, për qëllimet e kësaj nën-kredise, brenda fushes së veprimit (i) ose (ii) ;
- (h) Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të zhvillojë bizneset e tij/saj në përputhje me rregulloren kombëtare në lidhje me mjedisin, shëndetin dhe sigurinë dhe kushtet e punës;
- (i) Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të përdor fondet në kuader të Nën-Kredise në përputhje të plotë dhe strikte me Kriteret e Kualifikimit;
- (j) Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të zbatojë programin e ngritjes së kapaciteteve në kuader të ndihmës teknike të dhënë nga Banka për praktikën e mira ndërkombëtare në lidhje me çështjet mjedisore dhe sociale në sektorin përkatës;

k) Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të njoftojë menjëherë Republikën e Kosovës për çdo propozim për të ndryshuar, pezulluar ose shfuqizuar çdo dispozitë materiale të statutit të tij dhe të këshillojë Republikën e Kosovës për çdo ndryshim material në ekzistencën e saj të korporatave;

(l) Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të njoftojë menjëherë Bankën nëse merr ndonjë informacion në lidhje me shkeljen e Paragrafit 2.01 (c) ose Paragrafit 2.01 (f) ose nëse ndonjë institucion financiar ndërkombëtar ka vendosur ndonjë sanksion ndaj Nën-Huamarrësit të Pranueshem për çdo praktikë të ndaluar. Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të bashkëpunojë në mirëbesim me Bankën dhe përfaqësuesit e saj në vlerësimin nëse një shkelje e tillë ka ndodhur, dhe do të përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo kërkesë nga Banka në lidhje me ndonjë shkelje të tillë të pretenduar dhe do të sigurojë mbështetje të dokumentuar për të tilla përgjigje sipas kërkesës së Bankës;

(m) Nën-Huamarrësi i Pranueshem do të sigurojë menjëherë Bankës informacione të duhura që Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme dhe do të lejojë përfaqësuesit e Bankës (përfshirë, çdo konsulent të angazhuar nga Banka) të vizitojnë Projektin ose cilindo prej ambienteve të tjera ku zhvillohet biznesi i Nën-Huamarrësit të Pranueshem ose ku po kryhet Projekti dhe të ketë akses në asetet, librat, llogaritë dhe regjistrimet e Nën-Huamarrësit të Pranueshem (përfshirë, me qëllim (i) për të lehtësuar monitorimin dhe vlerësimin e Bankës së Projektit dhe të mundësojë Bankës të ekzaminojë dhe adresojë çdo ankesë që lidhet me Projektin e bërë nën Mekanizmin e Ankesave të Projektit dhe (ii) të vlerësojë nëse një Praktikë e Ndaluar ka ndodhur në lidhje me Projektin ose transaksionet e parashikuara këtu); dhe

(n) Nën-Huamarrësi i Pranueshem nuk duhet dhe nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga zyrtarët e tij, drejtorët, punonjësit e autorizuar, bashkëpunëtorët, agjentët ose përfaqësuesit që të përfshihen në ndonjë praktikë të ndaluar në lidhje me projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar nga kjo marrëveshje. Pavarësisht nga ndonjë dispozitë tjetër e kësaj Marrëveshjeje, Nën-Huamarrësi i Pranueshem pranon që Banka mund të përdorë Politikën e Zbatimit dhe Procedurat në lidhje me pretendimet e Praktikave të Ndaluar (përfshirë në lidhje me Paragrafin 2.01 (f)) në lidhje me Projektin dhe transaksionet e parashikuara nga kjo Marrëveshje.

NENI V - PEZULLIMI

Paragrafi 5.01. Pezullimi

(a) Nëse e drejta e Republikës së Kosovës për të bërë tërheqje per kredi është pezulluar në bazë të Paragrafit [5.01] (Pezullimi) i Marrëveshjes së Kredise, e drejta e Huamarrësit të Pranueshem për të bërë tërheqje mund gjithashtu dhe në të njëjtën kohë të pezullohet ose anulohet nga Republika e Kosovës, sipas rastit.

(b) Pavarësisht çdo pezullimi, të gjitha dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të mbesin në fuqi dhe në efekt të plotë, përveç nëse parashikohet në mënyrë specifike këtu.

NENI VI – EFEKTIVITETI

Paragrafi 6.01. Data efektive

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga të dy palët e saj dhe do t'i nënshtrohet miratimit të Bankës.

Paragrafi 6.02. Ndërprerja e Performancës

Kur e gjithë shuma kryesore e kredisë dhe nën-kredisë është shlyer dhe kur interesi dhe të gjitha tarifatat që janë përlllogaritur në kredi dhe nën-kredi të jenë paguar, kjo marrëveshje dhe të gjitha detyrimet e palëve në vijim, do të përfundojnë menjëherë.

NENI VII – TË NDRYSHME

Paragrafi 7.01. Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje, kontest ose pretendim që lind nga apo lidhet me këtë Marrëveshje, ose shkelje, përfundim ose shpallje e pavlefshme, do të zgjidhet miqësisht nga palët nëse është e mundur përmes përdorimit të një ndërmjetësi të pajtuar nga palët ose nëse kjo deshton përmes arbitrazhit të pajtuar nga palët.

Paragrafi 7.02. Personat e Autorizuar

(a) Ministria e Financave e Republikës së Kosovës ose personi, personat e autorizuar me shkrim nga Ministri i Financave i Republikës së Kosovës për këtë qëllim mund, në emër të Republikës së Kosovës, të ndërmarrë ndonjë veprim ose ekzekutojë çdo dokument të kërkuar ose të lejuar sipas kesaj Marrëveshje.

(b) [*Titulli i personit të autorizuar të Nën-Huamarrësit të Pranueshëm*], ose çdo person, persona të autorizuar me shkrim nga [*Titulli i personit të autorizuar të Nën-Huamarrësit të Pranueshëm*] për këtë qëllim, mund që në emër të Nën-Huamarrësit të Pranueshëm. - të ndërmarrë ndonjë veprim ose të ekzekutojë ndonjë dokument të kërkuar ose të lejuar sipas kesaj Marrëveshje, duke përfshirë, ndërmarrjen e ndonjë veprimi të kërkuar ose të lejuar për t'u ndërmarrë sipas dispozitave të Paragrafit [3.02 (b)].

Paragrafi 7.03. Njoftimet

Çdo njoftim, kërkesë, që kërkohet ose lejohet të jepet ose bëhet sipas kesaj Marrëveshjeje do të jetë me shkrim dhe do të konsiderohet se është dhënë ose është bërë siç duhet kur të dorëzohet në menyre fizike, postë ose telefaks, në adresën e personit të specifikuar më poshtë ose ndonjë adresë tjetër siç është specifikuar me shkrim nga personi tek pala që njofton ose bën kërkesën:

Për Republikën e Kosovës:

Ministria e Financave
Qeveria e Republikës së Kosovës
Bulevardi Nëna Terezë
10000 Prishtinë
Kosovë

Per vemendje te: Ministrise se Financave
Telefaksi: +38138213113

Për [Emri i Nën-Huamarresit të Pranueshëm]

[Emri i Nën-Huamarresit të Pranueshëm]
[Adresa e Nën-Huamarresit të Pranueshëm]
Për vemendje të: [•]

Telefaksi: [•]

Paragrafi 7.04. Ndryshimet

Asnjë ndryshim i kësaj Marrëveshjeje nuk do të jetë efektiv, përveç nëse një ndryshim i tillë do të ekzekutohet me shkrim nga Republika e Kosovës dhe Nën-Huamarrësi i pranueshëm [dhe miratuar nga Banka në përputhje me Paragrafin 3.01(d) e Marrëveshjes së Kredisë].

Paragrafi 7.05. Gjuha Angleze

Çdo dokument i dërguar Bankës në përputhje me këtë Marrëveshje do të jetë në gjuhën angleze. Dokumentet në çfarëdo gjuhe tjetër duhet të shoqërohen nga një përkthim në anglisht i vërtetuar se është një përkthim i aprovuar, dhe përkthimi i tillë i aprovuar do të jetë përfundimtar.

NË DËSHMI TË KËSAJ, palët e paraqitura këtu, duke vepruar përmes përfaqësuesve të tyre të autorizuar, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në [shënoni numrin e kopjeve] kopje dhe të dorëzohet në [shënoni vendin dhe vendosni nënshkrimin) , që nga dita dhe viti i parë i shkruar më lartë.

REPUBLIKA E KOSOVËS

Nga _____

Emri:

Titulli:

[Emri i Nën-Huamarrësit të Pranueshëm]

Nga _____

Emri:

Titulli:

PLANI 1 - FORMULARI I VËRTETIMIT TË DISBURSIMIT TË NËN-KREDISË, DEKLARATA DHE KONFIRMIMI

[shenoni daten]

Banka Evropiane për Rindertim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londër EC2A 2JN
Mbretëria e Bashkuar
Për vemendjen e: Departamentit të Administrimit të Operacioneve
Faksi: +44-20-7338-6100

Subjekti: Operacioni Nr. 52167

Subjekti: Marrëveshja Subsidiare e Kredisë, me datë [_____] ndërmjet Republikës së Kosovës dhe [Emri i Nen-Huamarresit të Pranueshëm] ("Marrëveshja Subsidiare e Kredisë").

Zoteri:

Perveç nese përcaktohet ndryshe këtu, shprehjet e përkufizuara këtu do të kenë kuptimin që u atribuohet atyre nën Marrëveshjen Subsidiare të Kredise.

Ne, te nënshkruarit [Emri i Nën-Huamarrësit të Pranueshëm], pranojmë se kemi bërë shpenzimet e mëposhtme ("Shpenzimet e pranueshme");

[shënoni përshkrimin e shpenzimeve të bëra, shumën... - vini re se në çdo rast këto duhet të jenë detyrime afatshkurtra që duhet të paguhen brenda 12 muajsh, ose nëse paguhen para datës së Marrëveshjes së Nen-Kredise , brenda 12 muajve nga data e pagimit të tyre, e cila do të jetë jo më heret se data 1 Maj 2020, nga data e Marrëveshjes për Kredi për të mbuluar, ndër të tjera, pagesa për furnitorët, punonjësit (në lidhje vetëm me punonjësit e Nën-Huamarrësve të Pranueshëm, të cilat janë ose ndërmarrje në pronësi sheterore që ofrojnë shërbime të rëndësishme të infrastrukturës ose kompani në pronësi komunale që ofrojnë shërbime vitale të infrastrukturës), ose pagesa për të vazhduar operacionet thelbësore dhe mirëmbajtjen në bazë të kontratave të prokuruarash tashmë në vend, për përjashtimin e çdo pagese të taksave ose pagesa të shpenzimeve kapitale], si dëshmi janë bashkangjitur (Dëshmia A), në përputhje të plotë dhe strikte me Dispozitat e Marrëveshjes Subsidiare të Kredise dhe të Marrëveshjes së Kredise.

Ne konfirmojmë më tej se:

(a) jemi përballur me një humbje të të ardhurave për shkak të krizës pandemike COVID-19 dhe për rrjedhojë kemi kërkuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës të ndërmirren veprime në përputhje me dëshmitë e bashkangjitura (Dëshmia B);

(b) në mungesë të mbështetjes së likuiditetit nën Nën-Kredi, do të ekzistonte një rrezik i konsiderueshëm i rënies në shërbimin e infrastrukturës të siguruar nga ne vetë sipas dëshmisë së bashkangjitur (Dëshmia C);

(c) ne kemi përmbushur Kriteret e Kualifikueshme për qëllimet e disbursimit në bazë të Marrëveshjes së Kredise Subsidiare , përfshirë gjithashtu edhe për shmangien e dyshimit, në zbatimin e politikës se zbatimit dhe procedurave ; dhe

(d) disbursimi i të ardhurave të nën-kredisë do të përdoret nga ne vetëm dhe në menyrë ekskluzive për të përmbushur Shpenzimet e kualifikueshme.

Sinqerisht i juaji,

Për dhe ne emer të [*Emri i Nën-Huamarresit të Pranueshëm*]

Nga: _____

Emri:

Titulli:

Për konfirmim:

REPUBLIKA E KOSOVES

Nga: _____

Emri:

Titulli³:

Shtojcat:

- Deshmia A
- Deshmia B
- Deshmia C

³ Duhet të jetë një përfaqësues i autorizuar i Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes së Kredisë.

PLANI 2 - FORMULARI I VEPRIMIT INTEGRAL

[shëno datën]

Ministria e Financave
Qeveria e Republikës së Kosovës
Bulevardi Nëna Terezë
10000 Prishtinë
Kosovë

Per vemendje te: Ministrise se Financave
Faksi: +38138213113

Banka Evropiane per Rindertim dhe Zhvillim
One Exchange Square
Londer EC2A 2JN
Mbreteria e Bashkuar

Per vemendjen e: Departamentin e Administrimit te Operacioneve
Email: oad@ebrd.com

Metej” **Banke**”

Subjekti: Operacioni nr. 52167

Subjekti: Marrëveshja Subsidiare e Kredisë, me date [_____] ndërmjet Republikës së Kosovës dhe [Emri i Nen-Huamarresit te Pranueshem] ("Marrëveshja e Kredise Subsidiare ").

Te nderuar:

Përveç nese përcaktohet ndryshe këtu, shprehjet e përcaktuara do të kenë kuptimin që u atribuohet atyre nën Marrëveshjen Subsidiare te Kredise.

Në përputhje me dispozitat e Paragrafit [4.01 (f)] të Marrëveshjes Subsidiare te Kredise, ne, të nënshkruarit [*Emri i Kontraktuesit Substancial*], me këtë përfaqësojmë dhe garantojme, dhe ndërmarrin, si kusht për marrjen e fondeve të nën-kredise, si më poshtë:

(a) as [*Emri i Kontraktuesit Substancial*] dhe asnjë zyrtar, drejtor, punonjës të autorizuar, bashkëpunëtorë, agjentë ose përfaqësues të [*Emri i Kontraktuesit Substancial*] nuk kanë kryer ose kanë qene te angazhuar ne ndonjë Praktikë të Ndaluar në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar nga Marrëveshja e Kredise subsidiare;

b) [*Emri i Kontraktuesit Substancial*] nuk do të autorizojë ose lejojë asnjë nga oficerët e saj, drejtorët, punonjësit e autorizuar, bashkëpunëtorët, agjentët ose përfaqësuesit që të përfshihen në ndonjë praktikë të ndaluar në lidhje me Projektin ose ndonjë transaksion të parashikuar nga Marrëveshja e Kredise Subsidiare Pavarësisht ndonjë dispozite tjetër te Marrëveshjes së Kredise Subsidiare

[Emri i Kontraktuesit Substancial] me këtë pranon që Banka mund të perdore Politikën e Zbatimit dhe Procedurës⁴ në lidhje me pretendimet e Praktikave të Ndaluar (përfshirë këtu në lidhje me Paragrafin 2.01 (f) të Marrëveshjes së Kredise Subsidiare , siç është e aplikueshme, mutatis mutandis, per [[Emri i Kontraktuesit Substancial]] në lidhje me Projektin dhe transaksionet e parashikuara nga Marrëveshja e Kredise Subsidiare;

(c) [Emri i Kontraktuesit Substancial] do të njoftojë menjëherë Bankën nëse [Emri i Kontraktuesit Substancial] pranon ndonjë informacion në lidhje me shkeljen e Paragrafit 2.01 (f) ose Paragrafit 4.01 (n) të Marrëveshjes së Kredise Subsidiare, siç është e aplikueshme, mutatis mutandis, te [Emri i Kontraktuesit Substancial], ose nëse ndonjë institucion financiar ndërkombëtar ka shqiptuar ndonjë sanksion ndaj [Emrit të Kontraktuesit Substancial] për çdo praktikë të ndaluar. [Emri i Kontraktuesit Substancial] do të bashkëpunojë në mirëbesim me Bankën dhe përfaqësuesit e saj në vlerësimin nëse një shkelje e tillë ka ndodhur dhe do ti përgjigjet menjëherë dhe në detaje të arsyeshme çdo kërkesë nga Banka në lidhje me ndonjë shkelje të tillë të pretenduar dhe do të sigurojë mbështetje të dokumentuar për të siguruar një përgjigje të tillë sipas kërkesës së Bankës; dhe

(d) [Emri i Kontraktuesit Thelbësor] do ti sigurojë menjëherë Bankës informacione të duhura që Banka mund të kërkojë herë pas here në mënyrë të arsyeshme dhe do të lejojë përfaqësuesit e Bankës (përfshirë, çdo konsulent të angazhuar nga Banka) të vizitojnë Projektin ose cilindo nga ambientet e tjera ku zhvillohet biznesi i [Emri i Kontraktuesit Substancial] ose ku po kryhet Projektin dhe të ketë akses në asetet, librat, llogaritë dhe regjistrimet e [Emri i Kontraktuesit Substancial] (përfshirë, me qëllim (i) për të lehtësuar monitorimin dhe vlerësimin e Bankës së Projektit nga Banka dhe ti mundësojë Bankës të ekzaminojë dhe adresojë çdo ankesë që lidhet me Projektin e bërë në kuader të Mekanizmit të Ankesave të Projektit dhe (ii) të vlerësojë nëse një Praktikë e Ndaluar ka ndodhur në lidhje me Projektin ose transaksionet e parashikuara këtu).

Sinqerisht i juaji,

Per dhe ne emer te [*Emri i Kontraktuesit Substancial*]

Nga: _____

Emri:

Titulli:

Per pranim dhe konfirmim:

[*Emri i Nen-Huamarresit të Pranueshëm*]

⁴ Politika e Zbatimit dhe Procedurat e BERZH-it të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("BERZH") të datës 4 Tetor 2017 të disponueshme në <https://www.ebrd.com/news/publications/policies/enforcement-policy-and-procedures.html>

Nga: _____

Emri:

Titulli⁵:

Shtojcat:

- Dëshmia A: dëshmi të Pagesave Substanciale të propozuar për t'u financuar nga fondet e nën-kredisë
